



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3578/ 5 prot.

Datë 18 .12.2025

V E N D I M
Nr. 1879 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18 .12.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër. 3578/2025 prot., datë 12.12.2025 për procedurën e “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-68566-11-12-2025, me objekt “Blerje Motorcikleta për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,346,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26-11-2025 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “In Auto” shpk, me Nipt, M31417021V, dhe adresë: *Njësia Administrative nr. 11, Rruga: “Gjokë Doci”.*

Autoriteti Kontraktor: SH.A Ujesjellës Kanalizime Tiranë, me adresë: *Rruga “Sami Frashëri” Nr. 4, Tiranë, Shqipëri.*

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Ardian Basha” P.F., me Nipt L54621204H, me adresë: *Lagjja Kastrioti, rruga e Krujës, Durrës, Fushë Krujë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulet monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13-11-2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-68566-11-12-2025, me objekt “Blerje Motorcikleta për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,346,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26-11-2025 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.2. Në datën 05.12.2025 është bërë vlerësimi për procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si vijon:

1. “ARDIAN BASHA” PF	1.179.500 lekë	kualifikuar
2. “InAuto” sh.p.k	1.344.000 lekë	kualifikuar
3. “O&A” sh.p.k	1.345.955 lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 11.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Publikimin e Njoftimit e e fituesit paraprak për procedurën e prokurimit.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2025/6177,

datë 12.12.2025 dhe me Nr. 3578/2024 Prot., datë 12.12.2025 e operatorit ekonomik “In auto” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-68566-11-12-2025, me objekt “Blerje Motorcikleta për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,346,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26-11-2025 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ardian Basha” P.F në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), është hartuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3578/1 datë 16.12.2025 , lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datën 18.12.2025 , operatori ekonomik ankimues “InAuto” SHPK, ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike shkresën protokolluar me tonën Nr 3578/2, me objekt “ Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/6177, datë aplikimi online 12.12.2025, si vijon: “Bazuar në nenin 117, pika1, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dispozitat e së cilit parashikojnë të drejtën e ankimuesit që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet kësaj shkrese, subjekti “InAuto SHPK” me NIPT M31417021V, paraqet: Kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/6177, datë aplikimi online 12.12.2025, me Nr. protokollit të KPP 3578/2025, në procedurën e prokurimit: “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68566-11-12-2025, me objekt “Blerje Motorcikleta për nevojat e shoqërisë” me fond limit 1.346.667 (një milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26-11-2025 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “InAuto” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit , “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-68566-11-12-2025, me objekt “Blerje Motorcikleta për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,346,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26-11-2025 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjellës Kanalizime Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet: “1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues “InAuto” SHPK, për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 3578/2025.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/6177, protokolluar në datën 12.12.2025 me nr. 3578/2025 protokolli, e operatorit ekonomik “InAuto” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-68566-11-12-2025, me objekt “Blerje Motorcikleta për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,346,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26-11-2025 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e shtetit, të tarifës “InAuto” SHPK financiare të paguar nga operatori ekonomik “InAuto” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

